Në rastin e reduktimit të kapitalit aksionar për shkak të humbjeve, mund të mos bëhet, duke parashtruar arsyet për këtë në procesverbalin e asamblësë së parë, depozitimi paraprak në selinë e shoqërisë, i relacionit dhe i vërejtjeve, sipas nenit 2482-bis, parag. II, kod. civ.

Në rastin e referuar në nenin 2466, paragrafi II, kod. civ., në mungesë të ofertave për blerje, pjesëmarrja në kapitalin aksionar të ortakut në mospërbushje, nuk mund të shitet në ankand.

NENI 8- FINANCIMET E ORTAKËVE PËR SHOQËRINË DHE TITUJT E DEBITË

Përveç pagesave pa detyrim të shlyerjes, Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime që i nënshtrohen parashikimit të nenit 2467 të kod. civ. dhe në çdo rast në përputhje me legjislacionin *pro tempore* në fuqi në fushën e grumbullimit të kursimeve. Shoqëria, në përputhje me legjislacionin e detyrueshëm, mund të emetojë tituj debie për mbajtësin, ose emra me vendimin e Organit Administrativ.

NENI 9 - TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Transferimi i kuotave dhe/ose i së drejtës të zgjedhjes për to, me akt ndërmjet të gjallëve, i nënshtrohet kufizimeve të këtij neni;

Ortakut, i cili ka për qëllim të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, tek ortakët e tjerë ose tek një palë e tretë, kuotën e vet dhe/ose të drejtat e veta të zgjedhjes, duhet t'i ofrojë ato, me të drejtën e parablerjes për të gjithë ortakët e tjerë.

E drejta e parablerjes i takon secilit prej ortakëve në përpjesëtim me marrëdhëniet ekzistuese midis madhësisë së kuotës së tij dhe shumës së kuotave të ortakëve jo shitës.

Oferta e shitjes duhet t'i komunikohet çdo Ortaku me letër rekomande me konfirmim marrjeje, dërguar në adresën që rezulton nga Regjistri i Ndërmarrjeve, duke përfshirë çmimin dhe kushtet e

shitjes të kërkuara, ose të dakordësuara me blerësin/t potenciale, dhe emrat e këtyre të fundit.

Çdo ushtrim i të drejtës së parablerjes do të duhet t'i komunikohet Ortakut ofertues, në adresën që rezulton nga Regjistri i Ndërmarrjeve, me letër rekomandë me konfirmim marrjeje, dorëzuar në postë jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data e marrja e komunikimit të ofertës së referuar në paragrafin e mësipërm.

Ushtrimi i së drejtës së parablerjes sjell pranimin e pakushtëzuar të çmimit dhe kushteve të shitjes që paraqiten në komunikimin e ofertës. Ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ana e Ortakëve, sjell gjithashtu dhe detyrimin e secilit prej tyre për të blerë së bashku me gjithë pjesën e kuotës së ofruar për shitje dhe/ose me gjithë sasinë e të drejtave të zgjedhjes të ofruara për shitje, objekt i së drejtës së parablerjes, edhe pjesën proporcionale të kuotës së ofruar dhe/ose të drejtave të ofruara të zgjedhjes, që ndoshta kanë mbetur të pazgjedhura.

Nëse asnjë ortak nuk ushtron, sipas kushteve dhe mënyrave të përmendura më lart, të drejtën e vet të parablerjes, kuota dhe/ose të drejtat e zgjedhjes së ofruara mund të transferohen nga Ortaku ofertues, për sa kohë është në favor të subjektit/eve blerës të shënuara në njoftimin e ofertës, me çmimin dhe me kushtet e treguara aty dhe brenda afatit maksimal prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga afati i fundit i paraqitur për ushtrimin e parablerjes.

Transferimi i kuotës dhe/ose të drejtave të zgjedhjes tek Ortaket, që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes me kushtet dhe mënyrat e përmendura më lart, duhet të formalizohet e të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit të fundit për ushtrimin e së drejtës së parablerjes, parashikuar nga procedura e përmendur në këtë nen.

Për qëllimet e këtij neni, termi "Transferimi me akt ndërmjet të gjallëve" nënkupton çdo transaksion, edhe falas - duke përfshirë shitjen, shkëmbimin, kontributin në shoqëri, shitjen në bllok, dhenien peng me caktimin e të drejtës së votës për kreditorin penglënës, shkërrirjen dhe ndarjen - nga i cili vjen në mënyrë direkte ose indirekte, rezultati i transferimit tek palët e treta, të pronës dhe të drejtave reale përmes ushtrimit të së drejtës së votës për kuotat e Shoqërisë. Megjithatë, kalimi tek një shoqëri e besuar, ose rikalimi në ana e saj, pas paraqitjes së mandatit fiduciar tek pronaret efektive, nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij neni.

Nëse, në varësi të transaksionit në fjalë, vlera e transferimit të kuotave është në natyrë, ose nuk mund të përcaktohet, përcaktimi i vlerës së kuotave, që i nënshtrohen parablerjes, do t'i besohen një arbitri, i cili vepron sipas nenit 1349 të kodit civil, i emëruar me marrëveshje të përbashkët nga ortakët e përfshirë ose - në rast mosmarrëveshjeje - nga Kryetari i

Gjykatës së vendit, ku është selia e Shoqërisë, me iniciativën e ortakut më të interesuar.

NENI 10 - VENDIMET E ORTAKËVE - KOMPETENCAT

Ortakët vendosin për çështjet që i rezervohen kompetencës së tyre me ligj ose me këtë statut, si dhe për çështjet që Administratori i Vetëm, shumica e Administratorëve apo shumë aksionarë, që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar, ia paraqesin atyre për miratim.

NENI 11 - VENDIMET E ORTAKËVE - MËNYRAT

Vendimet e Ortakëve duhet të miratohen me vendim asambleje, sipas nenit 2479-bis të kodit civil, duke iu referuar fushave të treguara në numrat 4 dhe 5) të paragrafit të dytë të nenit 2479 të kodit civil, ose kur Administratori i vetëm, shumica e administratorëve, apo shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar. Duhet të vendoset nga asambleja edhe rasti i pjesëmarrjes në shoqëri të tjera që sjell përgjegjësi të pakufizuara për detyrimet e tyre, si dhe vendim në lidhje me rastet e parashikuara nga nenet 2482-bis k.c. dhe sa herë që ligji e kërkon detyrimisht këtë.

Kur nuk është e nevojshme metoda e asamblesë, vendimet e ortakëve merrem përmes konsultimeve me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, me metoda që në çdo rast duhet të garantojnë:

- të drejtën e të gjithë atyre që janë të regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, për të marrë pjesë në to brenda një date të arsyeshme të paracaktuar;
- komunikimin e vendimit për të gjithë administratorët dhe auditët efektivë, nëse janë emëruar;
- nënshkrimin nga Ortakët të dokumenteve, ku të rezultojë qartë: çështja objekt i vendimit, pëlqimi për të dhe data në të cilën është shprehur pëlqimi.

Dokumentacioni përkatës duhet të ruhet nga Shoqëria dhe të zbardhet në Librin e vendimeve të Ortakëve.

Neni 12 - KUORUMI

Vendimet e Ortakëve, goftë në Asamble (në në thirrjen e parë dhe të dytë), goftë për konsultim me shkrim ose pëlqim të shprehur me shkrim, miratohen nëse marrin votën e favorshme të shumë ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit aksionar.

NENI 13 - ASAMBLEJA E ORTAKËVE - THIRRJA

Mbledhja e Ortakëve thirret nga Organi Administrativ sa herë që shihet e përshtatshme prej tij, si dhe kur bëjnë kërkesë, duke treguar çështjet për t'u diskutuar, shumë Ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar.

Thirrja kryhet nëpërmjet një njoftimi të dorëzuar, të dërguar ose të përcjellë tek Ortakët të paktën 8 (tete) ditë para datës së caktuar për Asamblenë.

Njoftimi mund të dorëzohet në dorë ose të dërgohet me postë me letër rekomandë, ose të dërgohet me faks ose e-mail dhe duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbledhjes dhe listën e çështjeve që do të trajtohen.

Në njoftim mund të parashikohet një datë tjetër thirrjeje për rastin në të cilin në mbledhjen e parashikuar me thirrjen e parë, asambleja nuk rezulton se ligjërisht e konstituuar.

Asambleja e Ortakëve mund të thirret në gjithë territorin e vendit edhe jashtë selisë së regjistruar.

Sidoqoftë, vendimi konsiderohet i marrë, kur në të merr pjesë i gjithë kapitali thelemtar dhe gjithë Administratorët dhe, nëse janë emëruar, të gjithë auditët efektivë, janë të pranishëm ose të informuar për takimin dhe askush nuk është kundër diskutimit të çështjes.

NENI 14 - ASAMBLEJA - PJESEMARRJA E ORTAKËVE

Kanë të drejtë për të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar në Regjistrin e Shoqërive.

Votimi i fshehtë nuk pranohet.

Pranohet pjesëmarrja në Asamble edhe edhe nëpërmjet përfaqësuesve, në përputhje me procedurat dhe formalitetet e përcaktuara me ligj.

Asambleja e Ortakëve mund të mbahet në më shumë se një vend të lidhura me audio ose video, dhe me kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të shenohen në procesverbalin përkatës:

- t'i lejohet kryetarit të asamblesë të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe shpallë rezultatin e votimit;

- t'i lejohet subjektit që mban procesverbalin që të perceptojë në mënyrë të përshtatshme aktivitetin e asamblesë objekt i procesverbalit;

- t'u lejohet pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan mbi çështjet e rendit të ditës, duke parë, marrë e përcjellë dokumente.

- të paraqiten në njoftimin e thirrjes, (përveçse kur bëhet fjalë për Asamble totalitare) vendet audio ose audio-video të lidhura, ku mund të drejtohen pjesëmarrësit, për të konsideruar të kryer mbledhjen në vendin, ku do të jenë të pranishëm Kryetari i Asamblesë dhe mbajtësi i procesverbalit.

NENI 15 - KRYESIMI I ASAMBLESE

Asambleja kryesohet nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Bordit Drejtues ose, në rast të mungesës, refuzimit apo pengesës, nga Zëvendëskryetari dhe në rast mungese, refuzimi, apo pengese të këtij të fundit nga Administratori i deleguar; në rast refuzimi, pengese, apo heqje dorë nga një person tjetër i zgjedhur nga Asambleja.

Personi i cili kryeson Asamblenë verifikon rregullsinë e konstituimit, konstaton identitetin dhe legjitimitetin e personave të pranishëm, rregullon sjelljen e tij dhe konstaton rezultatet e votimit; për rezultatet e këtyre verifikimeve duhet të mbahet shënim në procesverbal.

NENI 16 - ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i Shoqërisë mund t'u besohet edhe jo Ortakëve.

Shoqëria mund të administrohet në mënyrë alternative:

- nga një Administrator i vetëm;
- nga një Bord Drejtues i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë;
- nga më shumë se një Administratorë, deri në maksimumi pesë të tillë, të cilëve u besohet administrimi veç e veç ose së bashku; në këtë rast, zbatohen respektivisht, nenet 2257 dhe 2258 të kodit civil.

Emërimi i anëtarëve të Organit Administrativ, zgjedhja e sistemit të administrimit dhe përcaktimi i numrit të Administratorëve, janë përgjegjësi e Ortakëve, sipas nenit 2479 të kodit civil.

Në bazë të neneve 2505, 2505-bis dhe 2506-ter të Kodit Civil, Organi Administrativ mund të vendosë bashkimin dhe ndarjen, në përputhje me përcaktimet ligjore. Anëtarët e organit administrativ rrine në detyrë për periudhën e treguar në aktin e emërimit ose, në mungesë, deri në revokim, ose dorëheqje dhe mund të rizgjidhen.

NENI 17 BORDI DREJTUES

Përveçse kur e parashikon Asambleja në aktin e emërimit, Bordi Drejtues zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij Kryetarin dhe ndoshta një ose më shumë Zëvendëskryetarë; ai gjithashtu mund të emërojë një ose më shumë Administratorë të deleguar si dhe një Sekretar, ky i fundit edhe në mënyrë të përhershme dhe gjithashtu i huaj për vetë Këshillin.

Bordi Drejtues mund të delegojë atributet e veta në tërësi ose pjesërisht, në mënyrë individuale për një ose më shumë prej anëtarëve të tij, përfshirë Kryetarin, Zëvendëskryetarët dhe Anunistratorët e Deleguar, duke emëruar edhe një Komitet Ekzekutiv, duke përcaktuar kufijtë e kompetencave dhe të drejtave të caktuara. Bordi Drejtues mund t'i japë gjithashtu detyra të veçanta anëtarëve të tij.

Bordi Drejtues mbledhet gjithashtu në vende të ndryshme nga selia, për aq kohë sa është në Itali, sa herë që Kryetari ose

Zëvendëskryetari apo Administratori i Deleguar e konsiderojnë të nevojshme ose kur bëhet një kërkesë me shkrim nga shumica e anëtarëve të tij.

Thirrja bëhet nga Kryetari, Nënkyetari apo nga Administratori i deleguar me njoftim të dorëzuar personalisht, të dërguar me postë ose me telegram, telefaks ose e-mail për çdo anëtar të Bordit Drejtues, për Auditin e Vetëm dhe çdo anëtar efektiv të Bordit të Auditëve, nëse është krijuar, së paku tre (3) ditë pune para datës së mbledhjes, ose, në rast urgjence, të paktën një (një) ditë më parë.

Sidoqoftë do të konsiderohen të konstituara në mënyrë të vlefshme mbledhjet e Bordit Drejtues, edhe pa thirrje zyrtare, kur janë të pranishëm, edhe me telekonferencë ose videokonferencë, siç përshkruhet më poshtë, të gjithë Administratorët dhe, nëse janë emëruar, të gjitha Auditët efektive.

Mbledhjet e Bordit Drejtues konstituohen në mënyrë të vlefshme me prezencën, edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës, sipas parashikimeve të mëposhtme, të anëtarëve të saj.

Bordi Drejtues vendos vlefshmërisht me votën pro të shumicës absolute të votave të të pranishmëve. Çdo Administrator ka një votë. Në rastin e barazisë së votave, çështja do të jetë subjekt i vendimit të Ortakëve.

Mbledhjet e Bordit Drejtues kryesohen nga Kryetari i tij ose, në rast të mungesës ose pengesës së tij, nga Zëvendëskryetari, nëse zgjidhet dhe, në mungesë, apo në rast të mungesës ose pengesës së këtij të fundit, nga Administratori i Deleguar, nëse zgjidhet. Në mungesë dhe në rast pengesë edhe të Administratorit të Deleguar, mbledhja kryesohet nga Administratori i caktuar nga pjesëmarrësit.

Vendimet e Bordit Drejtues duhet të konstatohen nga një procesverbal i nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

Anëtarët mund të kundërshtojnë vendimet e Bordit Drejtues që dëmtojnë

të drejtat e tyre me të njëjtat kushte me të cilat mund të kundërshtojnë vendimet e asamblesë.

Mbledhjet e Bordit Drejtues mund të mbahen gjithashtu edhe me videokonferencë, ose telekonferencë, me kusht që secili nga pjesëmarrësit të identifikohet nga gjithë të tjerët dhe të jetë në gjendje të ndërhyjë në kohë reale gjatë diskutimit të çështjeve të shqyrtuara, si dhe të marrë, përcjellë dhe shikojë dokumentet. Nëse plotësohen këto kushte, mbledhja konsiderohet të mbahet në vendin ku ndodhen kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

Përveçse kur shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues kërkon metodën kolegjiale, vendimet e këtij organi mund të miratohen me konsultim me shkrim ose në bazë të pëligimit të shprehur me shkrim, me kusht që të gjithë Administratorëve në zyrë, ti jepet

e drejta, për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Në këtë rast, dokumentet e nënshkuara nga Administratorët, duhet të tregojnë qartë çështjen objekt i vendimit dhe përqimin për të nga shumica e Administratorëve në detyrë.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të mbahen nga Shoqëria dhe vendimet duhet të zbardhen në librin e vendimeve të Administratorëve.

Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e mëposhtëm, nëse gjatë vitit financiar mungojnë një ose më shumë anëtarë të Bordit Drejtues, të tjerët do t'i zëvendësojnë ata me bashkëzgjedhje dhe Administratorët e emëruar kështu do të qëndrojnë në detyrë deri në vendimin e ardhshëm të Ortakëve.

Nëse për shkak të dorëheqjes ose për shkaqe të tjera mungon shumica e Administratorëve, si të emëruar me vendim të Ortakëve, ashtu dhe të bashkëzgjedhur, në përputhje me paragrafin e mësipërm, konsiderohet menjëherë i rënë i gjithë Bordi Drejtues me efekt nga momenti i rikonstituimit të tij, që duhet të bëhet me vendim të Ortakëve, i cili duhet të merret me urgjencë.

NENI 18 - TË DREJTAT E ADMINISTRIMIT

Administratorit të vetëm i jepen të drejta të plota për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveçse, kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit.

Bordi Drejtues është i pajisur me të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë.

Në rastin, kur administrimi i është besuar shumë Administratorëve veçmas ose bashkërisht, Ortakët, në momentin e emërimit, do të përcaktojnë se për cilat akte ata do të veprojnë së bashku, për cilat do të veprojnë në mënyrë individuale dhe cilat akte do t'i rezervohen kompetencës ekskluzive të Ortakëve.

Organi Administrativ mund të emërojë dhe shkarkojë Drejtorët dhe Drejtorët e Përgjithshëm.

NENI 19 - PËRFAQËSIMI

Administratorit të Vetëm, Kryetarit të Bordit Drejtues, Zëvendëskryetarit dhe/ose Administratorëve të Deleguar, në kontekstin e kompetencave të dhëna i takon përfaqësimi i Shoqërisë, me firmë të lirë dhe të veçantë. Nëse administrimi i besohet më shumë Administratorëve individualisht ose bashkërisht, përfaqësimi duhet të ushtrohet më vete ose bashkërisht, sipas përcaktimit të Ortakëve në aktin e emërimit të tyre.

Çdo Administrator, të cilit i takon përfaqësimi mund të emërojë dhe revokojë, brenda kufijve të të drejtave të dhëna atij, manaxherë e përfaqësues për akte apo kategori të caktuar aktesh edhe me të drejtën e delegimit.

NENI 20 - KOMPENSIMI I ADMINISTRATORËVE

Administratoret kanë të drejtën e rimborsimit të shpenzimeve të bëra për arsye zyrtare.

Kompensimet që u takojnë Administratorëve përcaktohen nga Asambleja, e cila mund të caktojë një kompensim, si në një masë fikse, si në formën e pjesëmarrjes në rezultatin e vitit financiar, ose në fitimet apo të ardhurat, e realizuara, ashtu dhe me caktimin e të mirave dhe / ose të drejtave të shoqërisë, si dhe të përcaktojë një dëmshpërblim në fund të mandatit.

Asambleja mund të caktojë edhe shumën e përgjithshme për shpërblimin e të gjithë Administratorëve, duke përfshirë ata që janë investuar në detyra të veçanta; në këtë rast Bordi Drejtues përcakton shpërndarjen e shpërblimeve për Administratorët me detyra të veçanta, pasi ka dëgjuar mendimin e Bordit të Auditëve, nëse është emëruar.

Nëse Asambleja nuk ka vepruar në pajtim me paragrafin e mësipërm, për shpërblimin e Administratorëve me detyra të veçanta, vendos Bordi Drejtues, pasi ka dëgjuar mendimin e Bordit të Auditëve, nëse është emëruar.

NENI 21 - ORGANI I KONTROLLIT

Në rastet e parashikuara detyrimisht me ligj dhe kur Ortakët e gjykojnë të arsyeshme, ata do të emërojnë një Audit të Vetëm (kur ekzistojnë kushtet) ose një Bord Auditësh, të përbërë nga tre audite efektive dhe dy alternative, me funksionet dhe kompetencat e referuara në nenet 2403 dhe vijues të kodit civil, përveç sa parashikohet më poshtë lidhur me rishikimin ligjor të llogarive.

Kryetari i Bordit zgjidhet nga Ortakët në aktin e emërimit.

Paga vjetore e Auditit të Vetëm dhe e auditëve efektive duhet të përcaktohet me vendim të Ortakëve në aktin e emërimit të tyre për gjithë kohën e detyrës së tyre.

Mbledhjet e Bordit të Auditëve mund të mbahen edhe me videokonferencë ose telekonferencë me po ato procedura dhe formalitete të përcaktuara në këtë statut për mbledhjet e Bordit Drejtues.

Për sa nuk rregullohet këtu Audit i Vetëm ose Bordi i Auditëve, janë funksionale në kuptim të ligjit.

Në rastet e parashikuara detyrimisht nga ligji dhe kur Ortakët e gjykojnë të përshtatshme, rishikimi ligjor i llogarive, me vendim të Ortakëve, ushtrohet:

- Nga Audit i Vetëm ose Bordi i Auditëve, i formuar tërësisht nga revizorët ligjorë të regjistruar në një regjistër të posaçëm,

Ose

- Nga një revizor ligjor i llogarive, ose nga një shoqëri e revizionit ligjor të regjistruar në regjistrin e posaçëm, të emëruar e funksionale sipas ligjit.

NENI 22 - BILANCI DHE FITIMET

Viti financiar mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Bilanci duhet të miratohet nga Ortakët Brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit financiar të shoqërisë, nëse ligji e lejon, mund të miratohet prej tyre edhe brenda afatit maksimal prej njëqind e tetëdhjetë ditësh nga mbyllja e vitit financiar. Fitimet neto, pas zbritjes së kuotës, që destinohet për rezervën ligjore, do t'i ndahen ortakëve, me përjashtim të rastit kur asambleja vendos ndryshe.

NENI 23-SHPËRBERJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria shpërbëhet në rastet e e parashikuara nga ligji.

Emërimi i likuiduesit/ve, përcaktimi i kërkesave të tyre dhe i të drejtave të tyre si dhe përkufizimi i normave për likuidimin do të bëhet me vendim të Ortakëve.

NENI 24 - TËRHEQJA

Ortaku mund të tërhiqet nga Shoqëria në rastet e parashikuara me ligj. Vullneti për t'u tërhequr duhet t'i komunikohet organit administrativ me letër rekomande me konfirmim marrjeje brenda tridhjetë ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive të vendimit që e legjitimon.

Ushtrimi i së drejtës së tërheqjes, duhet të komunikohet në Regjistrin e Shoqërive nga Organi administrativ. Pjesëmarrjet, për të cilat është ushtruar e drejta e tërheqjes nuk mund të transferohen. Tërheqja nuk mund të ushtrohet, dhe nëse është ushtruar është e pavlerë, kur shoqëria revoco vendimin që e ka legjitimuar atë.

Ortaku që tërhiqet nga shoqëria ka të drejtën e rimbursimit të pjesëmarrjes së vet në përpjestim me pasuritë e shoqërisë, duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të shoqërisë, të ardhurat e saj, vlerën e të mirave materiale dhe jomateriale që posedon ajo, pozicionin e tyre në treg dhe çdo rrethanë tjetër apo kusht që mbahet normalisht parasysh, për përcaktimin e vlerës së tregut për pjesëmarrjet e shoqërisë. Në rast kontradikte përcaktimi bëhet në bazë të një relacioni të betuar të hartuar nga një ekspert i gjykatës në bazë të ligjit, me kërkesë të palës me të interesuar.

Kompensimi duhet të kryhet me mënyrat e parashikuara nga ligji, brenda njëqind e tetëdhjetë ditësh nga komunikimi i vullnetit për t'u tërhequr.

(pulla e taksës, vula)

SHTOJCA "B" E PROJEKTIT TË NDARJES

STATUT

NENI 1 - EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin

"ALPHA SESTANTE S.r.l."

NENI 2) - AKTIVITETI QË PËRBËN OBJEKTIN E SHOQËRISË

Shoqëria ka si objekt aktiviteti

- Marrjen, mbajtjen dhe menaxhimin e pjesëmarrjeve në fitime, të kuotave dhe/ose aksioneve, të përfaqësuara apo jo nga tituj të ndryshëm, në kapitalin e shoqërive të tjera, në entet, konsorciumet apo sipërmarrjet.

Gjithashtu shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregëtare, me sende të luajtshme e të paluajtshme, operacione financiare të nevojshme apo të duhura për realizimin e objektit të shoqërisë. Për këtë qëllim shoqëria, në mënyrë të veçantë, mund të:

- Marrë obligacione të shoqërive që janë pjesë e të njëjtit grup, si dhe t'u japë atyre financime të çdo forme;
 - Japë garanci bankare, garanci për kambiale, të lejojë regjistrimin e hipotekave mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë e të japë çdo garanci tjetër reale dhe/ose personale për debi e obligacione të veta, apo të shoqërive të tjera, që bëjnë pjesë në të njëjtin grup;
 - Të bëjë të gjitha shërbimet që kanë lidhje me menaxhimin e pjesëmarrjeve;
- Gjithçka jo ndaj publikut dhe duke përjashtuar veprimet e që i rezervon ligji të regjistruarve në regjistrat profesionale, parashikuar nga Dek. Legj. nr. 58, datë 24 shkurt 1998.

NENI 3 - SELIA

Shoqëria e ka selinë në Komunën e Milanos.

Organi administrativ mund të krijojë, transferojë e të mbyllë zyra përfaqësimi, filiale, njësi lokale, si në Itali dhe jashtë saj. Është gjithmonë kompetencë e organit administrativ edhe transferimi i selisë ligjore brenda së njëjtës komunë.

NENI 4 - ADRESA E ORTAKËVE

Adresa e ortakëve për marrëdhëniet që kanë me shoqërinë, është ajo që rezulton nga Regjistri i Bizneseve.

Gjithashtu ortakët janë të detyruar t'i japin kompanisë një adresë e-maili dhe një numër faksi, për çdo informacion që mund të bëhet edhe me këtë mjet.

NENI 5 - KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë deri më 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2060 (dymijë e gjashtëdhjetë) dhe mund të shtyhet ose të fshihet para kohe sipas modaliteteve ligjore.

NENI 6 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në shumën 10.000,00 (dhjetë mijë) Euro, i ndarë në kuota, në bazë të nenit 2468 të kodit civil.

NENI 7- VEPRIMET ME KAPITALIN

Në respektim të dispozitave të detyrueshme, kapitali i shoqërisë mund të rritet edhe me ofrimin e sendeve të tjera që nuk janë para, duke përfshirë punët dhe shërbimet në favor të shoqërisë. Me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 2482 të kodit civil, rritja e kapitalit të shoqërisë mund të bëhet edhe ofrimin e kuotave të një ematimi të ri tek palët e treta. Në këtë rast u takon ortakëve që nuk kanë miratuar vendimin, e drejta e tërheqjes në bazë të nenit 2473 të kodit civil.

Në rastin e reduktimit të kapitalit aksionar për shkak të humbjeve, mund të mos bëhet, duke parashtruar arsyet për këtë në procesverbalin e asamblesë së parë, depozitimi paraprak në seline e shoqërisë, i relacionit dhe i vërejtjeve, sipas nenit 2482-bis, paragraf. II, kod. civ.

Në rastin e referuar në nenin 2466, paragrafi II, kod. civ., në mungesë të ofertave për blerje, pjesëmarrja në kapitalin aksionar të ortakut në mospërmbushje, nuk mund të shitet në ankand.

NENI 8- FINANCIMET E ORTAKËVE PËR SHOQËRINË DHE

TITUJT E DEBITIT

Përveç pagesave pa detyrim kthimi, Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime që i nënshtrohen parashikimit të nenit 2467 të kod. civ. dhe në çdo rast në përputhje me legjislacionin *pro tempore* në fuqi në fushën e grumbullimit të kursimeve.

Shoqëria, në përputhje me legjislacionin e detyrueshëm, mund të emetojë tituj debite për mbajtësin, ose nominale me vendimin e Organit Administrativ.

NENI 9 - TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Transferimi i kuotave dhe/ose i të drejtave të zgjedhjes për to, me akt ndërmjet të gjallëve, i nënshtrohet kufizimeve të këtij neni;

Ortakut, i cili ka për qëllim të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, tek ortakët e tjerë ose tek një palë e tretë, kuotën e vet dhe/ose të drejtat e veta të zgjedhjes, duhet t'i ofrojë ato, me të drejtën e parablerjes për të gjithë ortakët e tjerë.

E drejta e parablerjes i takon secilit prej ortakëve në përpjesëtim me marrëdhënien ekzistuese midis madhësisë së kuotës së tij dhe shumës së kuotave të ortakëve jo shitës.

Oferta e shitjes duhet t'i komunikohet çdo Ortaku me letër rekomande me konfirmim marrjeje, dërguar në adresën që rezulton nga Regjistri i Bizneseve, duke përfshirë çmimin dhe kushtet e shitjes të kërkuara, ose të dakordsuara me blerësin/t potencialë, dhe emrat e këtyre të fundit.

Çdo ushtrim i të drejtës së parablerjes do të duhet t'i komunikohet Ortakut ofertues, në adresën që rezulton nga Regjistri i Ndërmarrjeve, me letër rekomande me konfirmim marrjeje, dorëzuar në postë jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data e marrja e komunikimit të ofertës së referuar në paragrafin e mësipërm.

Ushtrimi i së drejtës së parablerjes sjell pranimin e pakushtëzuar të çmimit dhe kushteve të shitjes që paraqiten në komunikimin e ofertës. Ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ana e Ortakeve, sjell gjithashtu dhe detyrimin e secilit prej tyre për të blerë së bashku me gjithë pjesën e kuotës së ofruar për shitje dhe/ose me gjithë sasinë e të drejtave të zgjedhjes të ofruara për shitje, objekt i së drejtës së parablerjes, edhe pjesën proporcionale të kuotës së ofruar dhe/ose të drejtave të ofruara të zgjedhjes, që ndoshta kanë mbetur të pazgjedhura.

Nëse asnjë ortak nuk ushtron, sipas kushteve dhe mënyrave të përmendura më lart, të drejtën e vet të parablerjes, kuota dhe/ose të drejtat e zgjedhjes së ofruara mund të transferohen nga Ortaku ofertues, për sa kohë është në favor të subjektit/eve blerës të shënuara në njoftimin e ofertës, me çmimin dhe me kushtet e treguara aty dhe brenda afatit maksimal prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga afati i fundit I paraqitur për ushtrimin e së drejtës së parablerjes.

Transferimi i kuotës dhe/ose të drejtave të zgjedhjes tek Ortakët, që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes me kushtet dhe mënyrat e përmendura më lart, duhet të formalizohet e të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit të fundit për ushtrimin e së drejtës së parablerjes, parashikuar nga procedura e përmendur në këtë nen.

Për qëllimet e këtij neni, termi "Transferimi me akt ndërmjet të gjallëve" nënkupton çdo transaksion, edhe falas - duke përfshirë shitjen, shkëmbimin, kontributin në shoqëri, shitjen në bllok, dhënien peng me caktimin e të drejtës së votës për kreditorin penglënës, shkrirjen dhe ndarjen - nga i cili vjen në mënyrë direkte ose indirekte, rezultati i transferimit tek palët e treta, të pronës dhe të drejtave reale përmes ushtrimit të së drejtës së votës për kuotat e Shoqërisë. Megjithatë, kalimi tek një shoqëri e besuar, ose rikalimi nga ana e saj, pas paraqitjes së mandatit fiduciar tek pronarët efektivë, nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij neni.

Nëse, në varësi të transaksionit në fjalë, vlera e transferimit të kuotave është në natyrë, ose nuk mund të përcaktohet, përcaktimi i vlerës së kuotave, që i nënshtrohen parablerjes, do t'i besohen një arbitri, i cili vepron sipas nenit 1349 të kodit

civil, i emëruar me marrëveshje të përbashkët nga ortakët e përfshirë ose - në rast mosmarrëveshjeje - nga Kryetari i Gjykatës së vendit, ku është selia e Shoqërisë, me iniciativën e ortakut më të interesuar.

NENI 10 - VENDIMET E ORTAKËVE - KOMPETENCAT

Ortakët vendosin për çështjet që i rezervohen kompetencës së tyre me ligj ose me këtë statut, si dhe për çështjet që Administratori I Vetëm, shumica e Administratorëve apo shumë aksionarë, që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar, ia paraqesin atyre për miratim.

NENI 11 - VENDIMET E ORTAKËVE - MENYRAT

Vendimet e Ortakëve duhet të miratohen me vendim asambleje, sipas nenit 2479-bis të kodit civil, duke iu referuar fushave të treguara në numrat 4 dhe 5) të paragrafit të dytë të nenit 2479 të kodit civil, ose kur e kërkon Administratori i vetëm, shumica e administratorëve, apo shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar. Duhet të vendoset nga asambleja edhe rasti i pjesëmarrjes në shoqëri të tjera që sjell përgjegjësi të pakufizuara për detyrimet e tyre, si dhe vendim në lidhje me rastet e parashikuara nga nenet 2482-bis të k.c. dhe sa herë që ligji e kërkon detyrimisht këtë.

Kur nuk është e nevojshme metoda e asamblesë, vendimet e ortakëve merren përmes konsultimeve me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, me metoda që në çdo rast duhet të garantojnë:

- të drejtën e të gjithë atyre që janë të regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, për të marrë pjesë në to brenda një date të arsyeshme të paracaktuar;

- komunikimin e vendimit për të gjithë administratorët dhe auditët efektivë, nëse janë emëruar;

- nënshkrimin nga Ortakët të dokumenteve, ku të rezultojë qartë: çështja objekt i vendimit, pëlqimi për të dhe data në të cilën është shprehur pëlqimi.

Dokumentacioni përkatës duhet të ruhet nga Shoqëria dhe të zbardhet në Librin e vendimeve të Ortakëve.

Neni 12 - KUORUMI

Vendimet e Ortakëve, qoftë në Asamble (në në thirrjen e parë dhe të dytë), qoftë për konsultim me shkrim ose pëlqim të shprehur me shkrim, miratohen nëse marrin votën e favorshme të shumë ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar

NENI 13 - ASAMBLEJA E ORTAKËVE - THIRRJA

Mbledhja e Ortakëve thirret nga Organi Administrativ sa herë që shihet e përshtatshme prej tij, si dhe kur bëjnë kërkesë, duke treguar çështjet për t'u diskutuar, shumë Ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar.

Thirrja kryhet nëpërmjet një njoftimi të dorëzuar, të dërguar ose të përcjellë tek Ortakët të paktën 8 (tete) ditë para datës së caktuar për Asamblenë.

Njoftimi mund të dorëzohet në dorë ose të dërgohet me postë me letër rekomande, ose të dërgohet me faks ose e-mail dhe duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbledhjes dhe listën e çështjeve që do të trajtohen.

Në njoftim mund të parashikohet një datë tjetër thirrjeje për rastin në të cilin në mbledhjen e parashikuar me thirrjen e parë, asambleja nuk rezulton ligjrisht e konstituuar.

Asambleja e Ortakëve mund të thirret në gjithë territorin e vendit edhe jashtë selisë së shoqërisë.

Në njoftimin e thirrjes mund të përcaktohet gjithashtu se, asambleja mbahet vetëm me mjete telekomunikacioni, duke mos paraqitur vendin fizik të zhvillimit të mbledhjes.

Sidoqoftë, vendimi konsiderohet i marrë, kur në të merr pjesë i gjithë kapitali themeltar dhe gjithë Administratorët dhe, nëse janë emëruar, të gjithë auditet efektive, janë të pranishëm ose të informuar për takimin dhe askush nuk del kundër diskutimit të çështjes.

NENI 14 - ASAMBLEJA - PJESEMARRJA E ORTAKËVE

Kanë të drejtë për të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar në Regjistrin e Bizneseve.

Votimi i fshehtë nuk pranohet.

Pranohet pjesëmarrja në Asamble edhe nëpërmjet përfaqësuesve, në përputhje me procedurat dhe formalitetet e përcaktuara me ligj.

Asambleja e Ortakëve mund të mbahet në më shumë se një vend të lidhur me audio ose video, dhe me kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të shënohen në procesverbalin përkatës:

- t'i lejohej kryetarit të asamblesë të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe shpallë rezultatin e votimit;
- t'i lejohej subjektit që mban procesverbalin që të perceptojë në mënyrë të përshtatshme aktivitetin e asamblesë objekt i procesverbalit;
- t'u lejohej pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan mbi çështjet e rendit të ditës, duke parë, marrë e përcjellë dokumente.

NENI 15 - KRYESIA E ASAMBLESE

Asambleja kryesohet nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Bordit Drejtues ose, në rast mungese, refuzimi, apo pengese, nga

Zëvendëskryetari dhe në rast mungese, refuzimi, apo pengese të këtij të fundit nga Administratori i deleguar; në rast refuzimi, pengese, apo heqje dorë nga një person tjetër i zgjedhur nga Asambleja.

Personi i cili kryeson Asambleenë verifikon rregullsinë e konstituimit, konstaton identitetin dhe legjitimitetin e personave të pranishëm, rregullon sjelljen e tij dhe konstaton rezultatet e votimit; për rezultatet e këtyre verifikimeve duhet të mbahet shënim në procesverbal.

Neni 16 - ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i Shoqërisë mund t'u besohet edhe jo Ortakëve.

Shoqëria mund të administrohet në mënyrë alternative:

- nga një Administrator i vetëm;
- nga një Bord Drejtues i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë;
- nga më shumë se një Administratore, deri në maksimumi pesë të tillë, të cilëve u besohet administrimi veç e veç ose së bashku; në këtë rast, zbatohen respektivisht, nenet 2257 dhe 2258 të kodit civil.

Emërimi i anëtarëve të Organit Administrativ, zgjedhja e sistemit të administrimit dhe përcaktimi i numrit të Administatoreve, janë përgjegjësi e Ortakëve, sipas nenit 2479 të kodit civil.

Në bazë të neneve 2505, 2505-bis dhe 2506-ter të Kodit Civil, Organi Administrativ mund të vendosë bashkimin dhe ndarjen, në përputhje me përcaktimet ligjore. Anëtarët e organit administrativ qëndrojnë në detyrë për periudhën e treguar në aktin e emërimit ose, në mungesë, deri në revokim, ose dorëheqje dhe mund të rizgjidhen.

NENI 17 - BORDI DREJTUES

Përveçse kur e parashikon Asambleja në aktin e emërimit, Bordi Drejtues zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij Kryetarin dhe ndoshta një ose më shumë Zëvendëskryetarë; ai gjithashtu mund të emërojë një ose më shumë Administatore të deleguar si dhe një Sekretar, ky i fundit edhe në mënyrë të të përhershme dhe gjithashtu i huaj për vetë Këshillin.

Bordi Drejtues mund të delegojë atributet e veta në tërësi ose pjesërisht, në mënyrë individuale njërën ose më shumë prej anëtarëve të tij, përfshirë Kryetarin, Zëvendëskryetarët dhe Anuninistatorët e Deleguar, duke emëruar edhe një Komitet Ekzekutiv, duke përcaktuar kufijtë e kompetencave dhe të drejtave të caktuara. Bordi Drejtues mund t'i japë gjithashtu detyra të veçanta anëtarëve të tij.

Bordi Drejtues mbledhet gjithashtu në vende të ndryshme nga selia, për atë kohë sa është në Itali, sa herë që Kryetari ose Zëvendëskryetari apo Administratori i Deleguar e konsiderojnë të

nevojshme ose kur bëhet një kërkesë me shkrim nga shumica e anëtarëve të tij.

Thirrja bëhet nga Kryetari, Nënkyetari apo nga Administratori i deleguar me njoftim të dorëzuar personalisht, të dërguar me postë ose me telegram, telefaks ose e-mail për çdo anëtar të Bordit Drejtues, për Auditin e Vetëm dhe çdo anëtar efektiv të Bordit të Auditëve, nëse është krijuar, së paku tre (3) ditë pune para datës së mbledhjes, ose, në rast urgjence, të paktën një (një) ditë më parë.

Gjithashtu në njoftimin e thirrjes mund të përcaktohet që mbledhja të zhvillohet vetëm me mjete telekomunikacioni, duke mos paraqitur vendin fizik të zhvillimit të mbledhjes.

Sidoqoftë do të konsiderohen të konstituara në mënyrë të vlefshme mbledhjet e Bordit Drejtues, edhe pa thirrje zyrtare, kur janë të pranishëm, edhe me telekonferencë ose videokonferencë, siç përshkruhet më poshtë, të gjithë Administratorët dhe, nëse janë emëruar, të gjitha Auditët efektivë.

Mbledhjet e Bordit Drejtues konstituohen në mënyrë të vlefshme me prezencën, edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës, sipas parashikimeve të mëposhtme, të anëtarëve të saj.

Bordi Drejtues vendos vlefshmërisht me votën pro të shumicës absolute të votave të të pranishmëve. Çdo Administrator ka një votë. Në rastin e barazisë së votave, çështja do të jetë subjekt i vendimit të Ortakëve.

Mbledhjet e Bordit Drejtues kryesohen nga Kryetari i tij ose, në rast të mungesës ose pengesës së tij, nga Zëvendëskryetari, nëse zgjidhet dhe, në mungesë, apo në rast të mungesës ose pengesës së këtij të fundit, nga Administratori i Deleguar, nëse zgjidhet. Në mungesë dhe në rast pengesë edhe të Administratorit të Deleguar, mbledhja kryesohet nga Administratori i caktuar nga pjesëmarrësit.

Vendimet e Bordit Drejtues duhet të konstatohen nga një procesverbal i nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

Ortakët mund të kundërshtojnë vendimet e Bordit Drejtues që dëmtojnë të drejtat e tyre me të njëjtat kushte me të cilat mund të kundërshtojnë vendimet e asamblesë, si të përputhshme.

Mbledhjet e Bordit Drejtues mund të mbahen gjithashtu edhe me videokonferencë, ose telekonferencë, me kusht që secili nga pjesëmarrësit të identifikohet nga gjithë të tjerët dhe të jetë në gjendje të ndërhyjë në kohë reale gjatë diskutimit të çështjeve të shqyrtuara, si dhe të marrë, përcjellë dhe shikojë dokumentet.

Përveçse kur shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues kërkon metodën kolegjiale, vendimet e këtij organi mund të miratohen me konsultim me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, me kusht që të gjithë Administratorëve në zyrë, t'u jepet

e drejta, për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Në këtë rast, dokumentet e nënshkuara nga Administratorët duhet të tregojnë qartë çështjen objekt I vendimit dhe pëlqimin për të nga shumica e Administratorëve në detyrë.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të mbahen nga Shoqëria dhe vendimet duhet të zbardhen në librin e vendimeve të Administratorëve.

Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e mëposhtëm, nëse gjatë vitit financiar mungojnë një ose më shumë anëtarë të Bordit Drejtues, të tjerët do t'i zëvendësojnë ata me bashkëzgjedhje dhe Administratorët e emëruar kështu do të qëndrojnë në detyrë deri në vendimin e ardhshëm të Ortakëve.

Nëse për shkak të dorëheqjes ose për shkaqe të tjera mungon shumica e Administratorëve, si të emëruar me vendim të Ortakëve, ashtu dhe të bashkëzgjedhur, në përputhje me paragrafin e mësipërm, konsiderohet menjëherë I rënë i gjithë Bordi Drejtues me efekt nga momenti i rikostituimit të tij, që duhet të bëhet me vendim të Ortakëve, I cili duhet të merret me urgjencë.

NENI 18 - TË DREJTAT E ADMINISTRIMIT

Administratorit të vetëm i jepen të drejta të plota për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveçse, kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit.

Bordi Drejtues është i pajisur me të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë.

Në rastin, kur administrimi i është besuar shumë Administratorëve veçmas ose bashkërisht, Ortakët, në momentin e emërimit, do të përcaktojnë se për cilat akte ata do të veprojnë së bashku, për cilat do të veprojnë në mënyrë individuale dhe cilat akte do t'i rezervohen kompetencës ekskluzive të Ortakëve.

Organi Administrativ mund të emërojë dhe shkarkojë Drejtorët dhe Drejtorët e Përgjithshëm.

NENI 19 - PËRFAQËSIMI

Administratorit të Vetëm, Kryetarit të Bordit Drejtues, Zëvendëskryetarit dhe/ose Administratorëve të Deleguar, në kontekstin e kompetencave të dhëna I takon përfaqësimi i Shoqërisë, me firmë të lirë dhe të veçantë.

Nëse administrimi i besohet më shumë Administratorëve individualisht ose bashkërisht, përfaqësimi duhet të ushtrohet me vete ose bashkërisht, sipas përcaktimit të Ortakëve në aktin e emërimit të tyre.

Çdo Administrator, të cilit i takon përfaqësimi mund të emërojë dhe revokojë, brenda kufijve të të drejtave të dhëna atij, manaxherë e përfaqësues për akte apo kategori të caktuar aktesh edhe me të drejtën e delegimit.

NENI 20 - KOMPENSIMI I ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra për arsye zyrtare.

Kompensimet që u takojnë Administratorëve përcaktohen nga Asambleja, e cila mund të caktojë një kompensim, si në një masë fikse, si në formën e e pjesëmarrjes në rezultatin e vitit financiar, ose në fitimet apo të ardhurat, e realizuara, ashtu dhe me caktimin e të mirave dhe / ose të drejtave të shoqërisë, si dhe të përcaktojë një demshpërblim në fund të mandatit.

Asambleja mund të caktojë edhe shumen e përgjithshme për shpërblimin e të gjithë Administratorëve, duke përfshirë ata që janë investuar në detyra të veçanta; në këtë rast Bordi Drejtues përcakton shpërndarjen e shpërblimeve për Administratorët me detyra të veçanta, pasi ka dëgjuar mendimin e Auditëve, nëse janë emëruar.

Nëse Asambleja nuk ka vepruar në pajtim me paragrafin e mësipërm, për shpërblimin e Administratorëve me detyra të veçanta, vendos Bordi Drejtues, pasi ka dëgjuar mendimin e Auditëve, nëse janë emëruar.

NENI 21 - ORGANI I KONTROLLIT

Në rastet e parashikuara detyrimisht me ligj dhe kur Ortakët e gjykojnë të arsyeshme, shoqëria emëron një organ kontrolli ose një revizor.

Organi i kontrollit mund të jetë monokratik ose kolegjal, i përbërë nga tre auditë efektivë dhe dy ndihmës. Revizori mund të jetë person fizik ose shoqëri revizioni.

Shoqëria mund të vendosë që t'ia besojë kontrollin e menaxhimit të organit të kontrollit dhe revizionin ligjor të llogarive revizorit.

Për sa më lart, të drejtat, kompetencat, afati dhe përbërja e organit të kontrollit dhe të revizorit, rregullohen, nga normat e përcaktuara për shoqëritë aksionere.

Mbledhjet e organit kolegjal të kontrollit, mund të mbahen edhe me telekonferencë sipas parashikimit në këtë fushë për Bordin Drejtues.

NENI 22 - BILANCI DHE FITIMET

Viti financiar mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Bilanci duhet të miratohet nga Ortakët brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit financiar të shoqërisë, nëse ligji e lejon, mund të miratohet prej tyre edhe brenda afatit maksimal prej njëqind e tetëdhjetë ditësh nga mbyllja e vitit financiar. Fitimet neto, pas zbritjes së kuotës, që duhet të destinohet për rezervën ligjore, do t'u ndahen ortakëve, me përjashtim të rastit kur asambleja vendos ndryshe.

NENI 23-SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria shpërbehet në rastet e e parashikuara nga ligji. Emërimi i likuiduesit/ve, përcaktimi i kërkesave të tyre dhe i të drejtave të tyre si dhe përkufizimi i normave për likuidimin do të bëhet me vendim të Ortakëve.

NENI 24- TËRHEQJA

Ortaku mund të tërhiqet nga Shoqëria në rastet e parashikuara me ligj.

Vullneti për t'u tërhequr duhet t'i komunikohet organit administrativ me letër rekomande me konfirmim marrjeje brenda tridhjetë ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive të vendimit që legjitimon tërheqjen, ose në mungesë të një vendimi, nga momenti kur ortaku merr dijeni për faktin që e legjitimon.

Ushtrimi i së drejtës së tërheqjes, duhet të komunikohet në Regjistrin e Shoqërive nga Organi administrativ. Pjesëmarrjet, për të cilat është ushtruar e drejta e tërheqjes nuk mund të transferohen. Tërheqja nuk mund të ushtrohet, dhe nëse është ushtruar është e pavlerë, kur shoqëria revokon vendimin që e ka legjitimuar atë.

Ortaku që tërhiqet nga shoqëria ka të drejtën e rimbursimit të pjesëmarrjes së vet në perpjestim me pasuritë e shoqërisë, duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të shoqërisë, të ardhurat e saj, vlerën e të mirave materiale dhe jomateriale që posedon ajo, pozicionin e saj në treg dhe çdo rrethanë tjetër apo kusht që mbahet normalisht parasysh, në përcaktimin e vlerës së tregut për pjesëmarrjet e shoqërisë. Në rast mosmarrëveshje përcaktimi bëhet në bazë të një relacioni të betuar të hartuar nga një ekspert i gjykatës në bazë të ligjit, me kërkesë të pales më të interesuar.

Kompensimi duhet të kryhet me mënyrat e parashikuara nga ligji, brenda njëqind e tetëdhjetë ditësh nga komunikimi i vullnetit për t'u tërhequr.

(Pulla e taksës, vula)

SHTOJCA "C" E PROJEKTIT TË NDARJES

STATUT

NENI 1 - EMËRTIMI

Themelohet një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin
"BETA SESTANTE S.r.l."

NENI 2) - AKTIVITETI QË PËRBËN OBJEKTIN E SHOQËRISË

Shoqëria ka si objekt aktiviteti

- Marrjen, mbajtjen dhe menaxhimin e pjesëmarrjeve në fitime, të kuotave dhe/ose aksioneve, të përfaqësuar apo jo nga tituj të ndryshëm, në kapitalin e shoqërive të tjera, në entet, konsorciumet apo sipërmarrjet.

Gjithashtu shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet tregëtare, me sende të luajtshme e të paluajtshme, operacione financiare të nevojshme apo të duhura për realizimin e objektivit të shoqërisë. Për këtë qëllim shoqëria, në mënyrë të veçantë, mund të:

- Marrë obligacione të shoqërive që janë pjesë e të njëjtit grup, si dhe t'u japë atyre financime të çdo forme;
- Japë garanci bankare, garanci për kambiale, të lejojë regjistrimin e hipotekave mbi sendet e paluajtshme të shoqërisë e të japë çdo garanci tjetër reale dhe/ose personale për debi e obligacione të veta, apo të shoqërive të tjera, që bëjnë pjesë në të njëjtin grup;
- Të bëjë të gjitha shërbimet që kanë lidhje me menaxhimin e pjesëmarrjeve;

Gjithçka jo ndaj publikut dhe duke përjashtuar veprimet e që i rezervon ligji të regjistruarve në regjistrat profesionale, parashikuar nga Dek. Legj. nr. 58, datë 24 shkurt 1998.

NENI 3 - SELIA

Shoqëria e ka selinë në Komunën e Milanos.

Organi administrativ mund të krijojë, transferojë e të mbyllë zyra përfaqësimi, filiale, njësi lokale, si në Itali dhe jashtë saj. Është gjithmonë kompetencë e organit administrativ edhe transferimi i selisë ligjore brenda së njëjtës komunë.

NENI 4 - ADRESA E ORTAKËVE

Adresa e ortakëve për marrëdhëniet që kanë me shoqërinë, është ajo që rezulton nga Regjistri i Bizneseve.

Gjithashtu ortakët janë të detyruar t'i japin kompanisë një adresë e-maili dhe një numër faksi, për çdo informacion që mund të bëhet edhe me këtë mjet.

NENI 5 - KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë deri më 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2060 (dymijë e gjashtëdhjetë) dhe mund të shtyhet ose të fshihet para kohe sipas modaliteteve ligjore.

NENI 6 - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është në shumën 10.000,00 (dhjetë mijë) Euro, i ndarë në kuota, në bazë të nenit 2468 të kodit civil.

NENI 7- VEPRIMET ME KAPITALIN

Në respektim të dispozitave të detyrueshme, kapitali i shoqërisë mund të rritet edhe me ofrimin e sendeve të tjera që nuk janë para, duke përfshirë punët dhe shërbimet në favor të shoqërisë.

Me përjashtim të rastit të parashikuar nga neni 2482 ter të kodit civil, rritja e kapitalit të shoqërisë mund të bëhet edhe ofrimin e kuotave të një emetimi të ri tek palët e treta. Në këtë rast u takon ortakëve që nuk kanë miratuar vendimin, e drejta e tërheqjes në bazë të nenit 2473 të kodit civil.

Në rastin e reduktimit të kapitalit aksionar për shkak të humbjeve, mund të mos bëhet, duke parashtruar arsyet për këtë në procesverbalin e asamblesë së parë, depozitimi paraprak në selinë e shoqërisë, i relacionit dhe i verejtjeve, sipas nenit 2482-bis, parag. II, kod. civ.

Në rastin e referuar në nenin 2466, paragrafi II, kod. civ., në mungesë të ofertave për blerje, pjesëmarrja në kapitalin aksionar të ortakut në mospërmbushje, nuk mund të shitet në ankand.

NENI 8- FINANCIMET E ORTAKËVE PËR SHOQËRINË DHE TITUJT E DEBITË

Përveç pagesave pa detyrim kthimi, Shoqëria mund të marrë nga ortakët financime që i nënshtrohen parashikimit të nenit 2467 të kod. civ. dhe në çdo rast në përputhje me legjislacionin *pro tempore* në fuqi në fushën e grumbullimit të kursimeve.

Shoqëria, në përputhje me legjislacionin e detyrueshëm, mund të emetojë tituj debie për mbajtësin, ose nominale me vendimin e Organit Administrativ.

NENI 9 - TRANSFERIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Transferimi i kuotave dhe/ose i të drejtave të zgjedhjes për to, me akt ndërmjet të gjallëve, i nënshtrohet kufirimeve të këtij neni;

Ortaku, i cili ka për qëllim të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, tek ortakët e tjerë ose tek një palë e tretë, kuotën e vet dhe/ose të drejtat e veta të zgjedhjes, duhet t'i ofrojë ato, me të drejtën e parablerjes për të gjithë ortakët e tjerë.

E drejta e parablerjes i takon secilit prej ortakëve në përpjesëtim me marrëdhënien ekzistuese midis madhësisë së kuotës së tij dhe shumës së kuotave të ortakëve jo shites.

Oferta e shitjes duhet t'i komunikohet çdo Ortaku me letër rekomande me konfirmim marrjeje, dërguar në adresën që rezulton nga Regjistri i Bizneseve, duke përfshirë çmimin dhe kushtet e shitjes të kërkuara, ose të dakordesuara me blerësin/të potenciale, dhe emrat e këtyre të fundit.

Çdo ushtrim i të drejtës së parablerjes do të duhet t'i komunikohet Ortakut ofertues, në adresën që rezulton nga Regjistri i Ndermarrjeve, me letër rekomande me konfirmim marrjeje, dorëzuar në postë jo më vonë se 20 (njëzet) ditë nga data e marrja e komunikimit të ofertës së referuar në paragrafin e mësipërm.

Ushtrimi i së drejtës së parablerjes sjell pranimin e pakushtëzuar të çmimit dhe kushteve të shitjes që paraqiten në komunikimin e ofertës. Ushtrimi i së drejtës së parablerjes nga ana e Ortakëve, sjell gjithashtu dhe detyrimin e secilit prej tyre për të blerë së bashku me gjithë pjesën e kuotës së ofruar për shitje dhe/ose me gjithë sasinë e të drejtave të zgjedhjes të ofruara për shitje, objekt i së drejtës së parablerjes, edhe pjesën proporcionale të kuotës së ofruar dhe/ose të drejtave të ofruara të zgjedhjes, që ndoshta kanë mbetur të pazgjedhura.

Nëse asnjë ortak nuk ushtron, sipas kushteve dhe mënyrave të përmendura më lart, të drejtën e vet të parablerjes, kuota dhe/ose të drejtat e zgjedhjes së ofruara mund të transferohen nga Ortaku ofertues, për sa kohë është në favor të subjektit/eve blerës të shënuara në njoftimin e ofertës, me çmimin dhe me kushtet e treguara aty dhe brenda afatit maksimal prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga afati i fundit i paraqitur për ushtrimin e së drejtës së parablerjes.

Transferimi i kuotës dhe/ose të drejtave të zgjedhjes tek Ortakët, që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes me kushtet dhe mënyrat e përmendura më lart, duhet të formalizohet e të kryhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e komunikimit të fundit për ushtrimin e së drejtës së parablerjes, parashikuar nga procedura e përmendur në këtë nen.

Për qëllimet e këtij neni, termi "Transferimi me akt ndërmjet të gjallëve" nënkupton çdo transaksion, edhe falas - duke përfshirë shitjen, shkëmbimin, kontributin në shoqëri, shitjen në bllok, dhënie peng me caktimin e të drejtës së votës për kreditorin penglënës, shkrirjen dhe ndarjen - nga i cili vjen në mënyrë direkte ose indirekte, rezultati i transferimit tek palët e treta, të pronës dhe të drejtave reale përmes ushtrimit të së drejtës së votës për kuotat e Shoqërisë. Megjithatë, kalimi tek një shoqëri e besuar, ose rikalimi nga ana e saj, pas paraqitjes së mandatit fiduciar tek pronarët efektivë, nuk i nënshtrohet dispozitave të këtij neni.

Nëse, në varësi të transaksionit në fjalë, vlera e transferimit të kuotave është në natyrë, ose nuk mund të përcaktohet, përcaktimi i vlerës së kuotave, që i nënshtrohen parablerjes, do t'i besohen një arbitri, i cili vepron sipas nenit 1349 të kodit

civil, i emëruar me marrëveshje të përbashkët nga ortakët e përfshirë ose - në rast mosmarrëveshjeje - nga Kryetari i Gjykatës së vendit, ku është selia e Shoqërisë, me iniciativën e ortakut më të interesuar.

NENI 10 - VENDIMET E ORTAKËVE - KOMPETENCAT

Ortakët vendosin për çështjet që i rezervohen kompetencës së tyre me ligj ose me këtë statut, si dhe për çështjet që Administratori I Vetëm, shumica e Administratorëve apo shumë aksionarë, që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar, ia paraqesin atyre për miratim.

NENI 11 - VENDIMET E ORTAKËVE - MËNYRAT

Vendimet e Ortakëve duhet të miratohen me vendim asambleje, sipas nenit 2479-bis të kodit civil, duke iu referuar fushave të treguara në numrat 4 dhe 5) të paragrafit të dytë të nenit 2479 të kodit civil, ose kur e kërkon Administratori i vetëm, shumica e administratorëve, apo shumë aksionarë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit themeltar. Duhet të vendoset nga asambleja edhe rasti i pjesëmarrjes në shoqëri të tjera që sjell përgjegjësi të pakufizuara për detyrimet e tyre, si dhe vendim në lidhje me rastet e parashikuara nga nenet 2482-bis të k.c. dhe sa herë që ligji e kërkon detyrimisht këtë.

Kur nuk është e nevojshme metoda e asamblesë, vendimet e ortakëve merren përmes konsultimeve me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, me metoda që në çdo rast duhet të garantojnë:

- të drejtën e të gjithë atyre që janë të regjistruar në Regjistrin e Shoqërive, për të marrë pjesë në to brenda një date të arsyeshme të paracaktuar;

- komunikimin e vendimit për të gjithë administratorët dhe auditët efektivë, nëse janë emëruar;

- nënshkrimin nga Ortakët të dokumenteve, ku të rezultojë qartë: çështja objekt i vendimit, pëlqimi për të dhe data në të cilën është shprehur pëlqimi.

Dokumentacioni përkatës duhet të ruhet nga Shoqëria dhe të zbardhet në Librin e vendimeve të Ortakëve.

Neni 12 - KUORUMI

Vendimet e Ortakëve, qortë në Asamble (në në thirrjen e parë dhe të dytë), qoftë për konsultim me shkrim ose pëlqim të shprehur me shkrim, miratohen nëse marrin votën e favorshme të shumë ortakëve që përfaqësojnë më shumë se gjysmën e kapitalit themeltar

NENI 13 - ASAMBLEJA E ORTAKËVE - THIRRJA

Mbledhja e Ortakëve thirret nga Organi Administrativ sa herë që shihet e përshtatshme prej tij, si dhe kur bëjnë kërkesë, duke treguar çështjet për t'u diskutuar, shumë Ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapital themeltar.

Thirrja kryhet nëpërmjet një njoftimi të dorëzuar, të dërguar ose të përcjellë tek Ortakët të paktën 8 (tete) ditë para datës së caktuar për Asamblenë.

Njoftimi mund të dorëzohet në dorë ose të dërgohet me postë me letër rekomande, ose të dërgohet me faks ose e-mail dhe duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbledhjes dhe listën e ështjeve që do të trajtohen.

Në njoftim mund të parashikohet një datë tjetër thirrjeje për rastin në të cilin në mbledhjen e parashikuar me thirrjen e parë, asambleja nuk rezulton ligjërisht e konstituuar.

Asambleja e Ortakëve mund të thirret në gjithë territorin e vendit edhe jashtë selisë së shoqërisë.

Në njoftimin e thirrjes mund të përcaktohet gjithashtu se, asambleja mbahet vetëm me mjete telekomunikacioni, duke mos paraqitur vendin fizik të zhvillimit të mbledhjes.

Sidoqoftë, vendimi konsiderohet i marrë, kur në të merr pjesë i gjithë kapitali themeltar dhe gjithë Administratorët dhe, nëse janë emëruar, të gjithë auditet efektive, janë të pranishëm ose të informuar për takimin dhe askush nuk del kundër diskutimit të ështjes.

NENI 14 - ASAMBLEJA - PJESEMARRJA E ORTAKËVE

Kanë të drejtë për të marrë pjesë në Asamblenë e Ortakëve të gjithë ata që rezultojnë të regjistruar në Regjistrin e Bizneseve.

Votimi i fshehtë nuk pranohet.

Pranohet pjesëmarrja në Asamble edhe nëpërmjet përfaqësuesve, në përputhje me procedurat dhe formalitetet e përcaktuara me ligj.

Asambleja e Ortakëve mund të mbahet në më shumë se një vend të lidhur me audio ose video, dhe me kushtet e mëposhtme, të cilat duhet të shënohen në procesverbalin përkatës:

- t'i lejohe kryetarit të asamblesë të verifikojë identitetin dhe legjitimitetin e pjesëmarrësve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe shpallë rezultatin e votimit;
- t'i lejohe subjektit që mban procesverbalin që të perceptojë në mënyrë të përshtatshme aktivitetin e asamblesë objekt i procesverbalit;
- t'u lejohe pjesëmarrësve të marrin pjesë në diskutim dhe në votimin simultan mbi ështjet e rendit të ditës, duke parë, marrë e përcjellë dokumente.

NENI 15 - KRYESIMI I ASAMBLESE

Asambleja kryesohet nga Administratori i Vetëm ose nga Kryetari i Bordit Drejtues ose, në rast mungese, refuzimi, apo pengese, nga

Zëvendëskryetari dhe në rast mungese, refuzimi, apo pengese të këtij të fundit nga Administratori i deleguar; në rast refuzimi, pengese, apo heqje dorë nga një person tjetër i zgjedhur nga Asambleja.

Personi i cili kryeson Asamblenë verifikon rregullsinë e konstituimit, konstaton identitetin dhe legjitimitetin e personave të pranishëm, rregullon sjelljen e tij dhe konstaton rezultatet e votimit; për rezultatet e këtyre verifikimeve duhet të mbahet shënim në procesverbal.

Neni 16 - ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrimi i Shoqërisë mund t'u besohet edhe jo Ortakëve.

Shoqëria mund të administrohet në mënyrë alternative:

- nga një Administrator i vetëm;
- nga një Bord Drejtues i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë;
- nga më shumë se një Administratorë, deri në maksimumi pesë të tillë, të cilëve u besohet administrimi veç e veç ose së bashku; në këtë rast, zbatohen respektivisht, nenet 2257 dhe 2258 të kodit civil.

Emërimi i anëtarëve të Organit Administrativ, zgjedhja e sistemit të administrimit dhe përcaktimi i numrit të Administratorëve, janë përgjegjësi e Ortakëve, sipas nenit 2479 të kodit civil.

Në bazë të neneve 2505, 2505-bis dhe 2506-ter të Kodit Civil, Organi Administrativ mund të vendosë bashkimin dhe ndarjen, në përputhje me përcaktimet ligjore. Anëtarët e organit administrativ qëndrojnë në detyrë për periudhën e treguar në aktin e emërimit ose, në mungesë, deri në revokim, ose dorëheqje dhe mund të rizgjidhen.

NENI 17 - BORDI DREJTUES

Përveçse kur e parashikon Asambleja në aktin e emërimit, Bordi Drejtues zgjedh nga radhët e anëtarëve të tij Kryetarin dhe ndoshta një ose më shumë Zëvendëskryetarë; ai gjithashtu mund të emërojë një ose më shumë Administratorë të deleguar si dhe një Sekretar, ky i fundit edhe në mënyrë të të përhershme dhe gjithashtu i huaj për vetë Këshillin.

Bordi Drejtues mund të delegojë atributet e veta në tërësi ose pjesërisht, në mënyrë individuale njërit ose më shumë prej anëtarëve të tij, përfshirë Kryetarin, Zëvendëskryetarët dhe Anunistratorët e Deleguar, duke emëruar edhe një Komitet Ekzekutiv, duke përcaktuar kufijtë e kompetencave dhe të drejtave të caktuara. Bordi Drejtues mund t'i japë gjithashtu detyra të veçanta anëtarëve të tij.

Bordi Drejtues mbledhet gjithashtu në vende të ndryshme nga selia, për aq kohë sa është në Itali, sa herë që Kryetari ose Zëvendëskryetari apo Administratori i Deleguar e konsiderojnë të

nevojshme ose kur bëhet një kërkesë me shkrim nga shumica e anëtarëve të tij.

Thirrja bëhet nga Kryetari, Nënkryetari apo nga Administratori i deleguar me njoftim të dorëzuar personalisht, të dërguar me postë ose me telegram, telefaks ose e-mail për çdo anëtar të Bordit Drejtues, për Auditin e Vetem dhe dhe çdo anëtar efektiv të Bordit të Auditëve, nëse është krijuar, së paku tre (3) ditë pune para datës së mbledhjes, ose, në rast urgjence, të paktën një (një) ditë më parë.

Gjithashtu në njoftimin e thirrjes mund të përcaktohet që mbledhja të zhvillohet vetëm me mjete telekomunikacioni, duke mos paraqitur vendin fizik të zhvillimit të mbledhjes.

Sidoqoftë do të konsiderohen të konstituara në mënyrë të vlefshme mbledhjet e Bordit Drejtues, edhe pa thirrje zyrtare, kur janë të pranishëm, edhe me telekonferencë ose videokonferencë, siç përshkruhet më poshtë, të gjithë Administratorët dhe, nëse janë emëruar, të gjitha Auditët efektivë.

Mbledhjet e Bordit Drejtues konstituohen në mënyrë të vlefshme me prezencën, edhe nëpërmjet telekonferencës ose videokonferencës, sipas parashikimeve të mëposhtme, të anëtarëve të saj.

Bordi Drejtues vendos vlefshmërisht me votën pro të shumicës absolute të votave të të pranishmëve. Çdo Administrator ka një votë. Në rastin e barazisë së votave, çështja do të jetë subjekt i vendimit të Ortakëve.

Mbledhjet e Bordit Drejtues kryesohen nga Kryetari i tij ose, në rast të mungesës ose pengesës së tij, nga Zëvendëskryetari, nëse zgjidhet dhe, në mungesë, apo në rast të mungesës ose pengesës së këtij të fundit, nga Administratori i Deleguar, nëse zgjidhet. Në mungesë dhe në rast pengesë edhe të Administratorit të Deleguar, mbledhja kryesohet nga Administratori i caktuar nga pjesëmarrësit.

Vendimet e Bordit Drejtues duhet të konstatohen nga një procesverbal i nënshkruar nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes.

Ortakët mund të kundërshtojnë vendimet e Bordit Drejtues që dëmtojnë të drejtat e tyre me të njëjtat kushte me të cilat mund të kundërshtojnë vendimet e asamblese, si të përputhshme.

Mbledhjet e Bordit Drejtues mund të mbahen gjithashtu edhe me videokonferencë, ose telekonferencë, me kusht që secili nga pjesëmarrësit të identifikohet nga gjithë të tjerët dhe të jetë në gjendje të ndërhyjë në kohë reale gjatë diskutimit të çështjeve të shqyrtuara, si dhe të marrë, përcjellë dhe shikojë dokumentet.

Përveçse kur shumica e anëtarëve të Bordit Drejtues kërkon metodën kolegjiale, vendimet e këtij organi mund të miratohen me konsultim me shkrim ose në bazë të pëlqimit të shprehur me shkrim, me kusht që të gjithë Administratorëve në zyrë, t'u jepet

e drejta, për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes. Në këtë rast, dokumentet e nënshkruara nga Administratorët duhet të tregojnë qartë çështjen objekt i vendimit dhe pëlqimin për të nga shumica e Administratorëve në detyrë.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të mbahen nga Shoqëria dhe vendimet duhet të zbardhen në librin e vendimeve të Administratorëve.

Përveç rasteve të parashikuara në paragrafin e mëposhtëm, nëse gjatë vitit financiar mungojnë një ose më shumë anëtarë të Bordit Drejtues, të tjerët do t'i zëvendësojnë ata me bashkëzgjedhje dhe Administratorët e emëruar kështu do të qëndrojnë në detyrë deri në vendimin e ardhshëm të Ortakëve.

Nëse për shkak të dorëheqjes ose për shkaqe të tjera mungon shumica e Administratorëve, si të emëruar me vendim të Ortakëve, ashtu dhe të bashkëzgjedhur, në përputhje me paragrafin e mësipërm, konsiderohet menjëherë i rënë i gjithë Bordi Drejtues me efekt nga momenti i rikonstituimit të tij, që duhet të bëhet me vendim të Ortakëve, i cili duhet të merret me urgjencë.

NENI 18 - TË DREJTAT E ADMINISTRIMIT

Administratorit të vetëm i jepen të drejta të plota për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveçse, kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit.

Bordi Drejtues është i pajisur me të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë.

Në rastin, kur administrimi i është besuar shumë Administratorëve veçmas ose bashkërisht, Ortaket, në momentin e emërimit, do të përcaktojnë se për cilat akte ata do të veprojnë së bashku, për cilat do të veprojnë në mënyrë individuale dhe cilat akte do t'i rezervohen kompetencës eskluzeve të Ortakëve.

Organi Administrativ mund të emërojë dhe shkarkojë Drejtorët dhe Drejtorët e Përgjithshëm.

NENI 19 - PËRFAQËSIMI

Administratorit të Vetëm, Kryetarit të Bordit Drejtues, Zëvendëskryetarit dhe/ose Administratorëve të Deleguar, në kontekstin e kompetencave të dhëna I takon përfaqësimi i Shoqërisë, me firme të lirë dhe të veçantë.

Nëse administrimi i besohet më shumë Administratorëve individualisht ose bashkërisht, përfaqësimi duhet të ushtrohet më vete ose bashkërisht, sipas përcaktimit të Ortakëve në aktin e emërimit të tyre.

Çdo Administrator, të cilit i takon përfaqësimi mund të emërojë dhe revokojë, brenda kufijve të të drejtave të dhëna atij, manaxherë e përfaqësues për akte apo kategori të caktuar aktesh edhe me të drejtën e delegimit.

NENI 20 - KOMPENSIMI I ADMINISTRATORËVE

Administratorët kanë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve të bëra për arsye zyrtare.

Kompensimet që u takojnë Administratorëve përcaktohen nga Asambleja, e cila mund të caktojë një kompensim, si në një masë fikse, si në formën e pjesëmarrjes në rezultatin e vitit financiar, ose në fitimet apo të ardhurat, e realizuara, ashtu dhe me caktimin e të mirave dhe / ose të drejtave të shoqërisë, si dhe të përcaktojë një dëmshpërblim në fund të mandatit.

Asambleja mund të caktojë edhe shumën e përgjithshme për shpërblimin e të gjithë Administratorëve, duke përfshirë ata që janë investuar në detyra të veçanta; në këtë rast Bordi Drejtues përcakton shpërndarjen e shpërblimeve për Administratorët me detyra të veçanta, pasi ka dëgjuar mendimin e Auditëve, nëse janë emëruar.

Nëse Asambleja nuk ka vepruar në pajtim me paragrafin e mësipërm, për shpërblimin e Administratorëve me detyra të veçanta, vendos Bordi Drejtues, pasi ka dëgjuar mendimin e Auditëve, nëse janë emëruar.

NENI 21 - ORGANI I KONTROLLIT

Në rastet e parashikuara detyrimisht me ligj dhe kur Ortakët e gjykojnë të arsyeshme, shoqëria emëron një organ kontrolli ose një revizor.

Organi i kontrollit mund të jetë monokratik ose kolegjal, i përbërë nga tre auditë efektivë dhe dy ndihmës. Revizori mund të jetë person fizik ose shoqëri revizioni.

Shoqëria mund të vendosë që t'ia besojë kontrollin e menaxhimit të organit të kontrollit dhe revizionin ligjor të llogarive revizorit.

Për sa më lart, të drejtat, kompetencat, afati dhe përbërja e organit të kontrollit dhe të revizorit, rregullohen, nga normat e përcaktuara për shoqëritë aksionere.

Mbledhjet e organit kolegjal të kontrollit, mund të mbahen edhe me telekonferencë sipas parashikimit në këtë fushë për Bordin Drejtues.

NENI 22 - BILANCI DHE FITIMET

Viti financiar mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të çdo viti.

Bilanci duhet të miratohet nga Ortakët brenda njëqind e njëzet ditëve nga mbyllja e vitit financiar të shoqërisë, nëse ligji e lejon, mund të miratohet prej tyre edhe brenda afatit maksimal prej njëqind e tetëdhjetë ditësh nga mbyllja e vitit financiar.

Fitimet neto, pas zbritjes së kuotës, që duhet të destinohet për rezervën ligjore, do t'u ndahen ortakëve, me përjashtim të rastit kur asambleja vendos ndryshe.

NENI 23-SHPËRBËRJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria shpërbëhet në rastet e e parashikuara nga ligji. Emërimi i likuiduesit/ve, përcaktimi i kërkesave të tyre dhe i të drejtave të tyre si dhe përkufizimi i normave për likuidimin do të bëhet me vendim të Ortakëve.

NENI 24- TËRHEQJA

Ortaku mund të tërhiqet nga Shoqëria në rastet e parashikuara me ligj.

Vullneti për t'u tërhequr duhet t'i komunikohet organit administrativ me letër rekomande me konfirmim marrjeje brenda tridhjetë ditëve nga regjistrimi në Regjistrin e Shoqërive të vendimit që legjitimon tërheqjen, ose në mungesë të një vendimi, nga momenti kur ortaku merr dijeni për faktin që e legjitimon.

Ushtrimi i së drejtës së tërheqjes, duhet të komunikohet në Regjistrin e Shoqërive nga Organi administrativ. Pjesëmarrjet, për të cilat është ushtruar e drejta e tërheqjes nuk mund të transferohen. Tërheqja nuk mund të ushtrohet, dhe nëse është ushtruar është e pavlerë, kur shoqëria revokon vendimin që e ka legjitimuar atë.

Ortaku që tërhiqet nga shoqëria ka të drejtën e rimbursimit të pjesëmarrjes së vet në përpjestim me pasuritë e shoqërisë, duke marrë në konsideratë gjendjen financiare të shoqërisë, të ardhurat e saj, vlerën e të mirave materiale dhe jomateriale që posedon ajo, pozicionin e saj në treg dhe çdo rrethanë tjetër apo kusht që mbahet normalisht parasysh, në përcaktimin e vlerës së tregut për pjesëmarrjet e shoqërisë. Në rast mosmarrëveshje përcaktimi bëhet në bazë të një relacioni të betuar të hartuar nga një ekspert i gjykatës në bazë të ligjit, me kërkesë të palës me të interesuar.

Kompensimi duhet të kryhet me mënyrat e parashikuara nga ligji, brenda njeqind e tetëdhjetë ditësh nga komunikimi i vullnetit për t'u tërhequr.

(Pulla e taksës, vula)

SHTOJCA "D" E PROJEKTIT TË NDARJES

DK SET – Kontabiliteti i përgjithshëm dhe të ardhurat
0037605 Sestante Holding Srl

20/02/2023

GJENDJA PASUORE NË SEKSIONE SIPAS KOMPETENCËS

Nga 01/01/2022 deri 31/12/2022

Parametra të tjerë: bilanci i mëparshëm, vetëm regjistrime me vlerë lokale

GJENDJA PASUORE

AKTIVET

	ASETE	15.112.891,65
050	Asete jomateriale	0,00
05010	Kostot e krijimit dhe zgjerimit	0,00
0501010	Kostot e krijimit dhe zgjerimit	4.994,15
050101010	Shpenzimet e themelimit dhe ndryshimit të shoqërisë	4.994,15
0501015	F. admin. kostot e krijimit dhe zgjerimit	-4.994,15
050101510	F. admin. shpenzime themelimi	-4.994,15
070	Asete financiare	15.112.891,65
07010	Pjesëmarrje	15.112.891,65
0701010	Pjesëmarrje në shoqëri të kontrolluara	15.112.891,65
070101010	Pjesëmarrje Alpine Invest Srl	500.000,00
070101050	Pjesëmarrje Local Web Srl	2.500.000,00
070101051	Pjesëmarrje IDS Italia Srl	1.300.000,00
070101052	Pjesëmarrje Homepal a Better Place Sr	416.299,50
070101053	Pjesëmarrje IDS SHPK	10.000.000,00
070101055	Pjesëmarrje We Web SHPK	731,64
070101057	Pjesëmarrje Quiple Srl	10.000,00
070101063	Pjesëmarrje Direct24 Web Advertising LTD	0,51
070101066	Pjesëmarrje Botzen Invest	365.000,00
070101067	Pjesëmarrje November Srl	10.000,00
070101068	Pjesëmarrje Super Agenda srl	10.000,00
070101070	Pjesëmarrje Best Shop Shpk	860,00
	AKTIVI QARKULLUES	3.224.799,20
100	Kredite	3.210.791,90
10015	Kredite për shoqëritë e kontrolluara	3.098.222,68
1001520	Kreditë për shoq. kontr. si dhe vitet fin pasardhëse	3.098.222,68
100152050	Kreditë vs Alpine Invest Srl	1.383.000,00
100152051	Kreditë vs Local Web Srl	20.222,68
100152052	Kreditë vs WE WEB SHPK	1.220.000,00
100152056	Kreditë financiare pafrut. Pradiumtech SHPK	30.000,00
100152058	Kreditë financiare pafrut. November Srl	410.000,00
100152059	Kreditë financiare pafrut. Best Shop On Line	35.000,00
10030	Kreditë kundrejt të tjerëve	112.569,22
1003010	Kreditë kundrejt të tjerëve të kërkueshme në vitin e ardhshëm financiar	95.761,70
100301003	Kreditë ndaj thesarit për mbajtjet e bëra	8,15
10030100315	Mbajtje mbi interesa aktive	8,15
100301009	Kredi në kompensim mbi F24	95.753,55
10030100910	TVSH në kompensim brenda vitit të ardhshëm fin.	18.978,99
10030100915	IRPEF/IRES në kompensim brenda vitit fin të ardhshëm	76.774,56
1003020	Kredi ndaj të tjerëve – parapagesa	16.807,52
100302025	Parapagesa furnitorëve	16.807,52

120	Likuiditete disponibël	14.007,30
12010	Depozita bankare e postare	13,874,75
1201015	Banka Intesa San Paolo	6.408,99
1201020	Arka Rurale Renon e/4042275	7.465,76
12020	Para e vlera në arkë	132,55
1202010	Arka e të hollave në vend	132,55
	GJITHSEJ AKTIVE	18.337.690,85

PASIVET

PASURIA NETO		12.861.330,00
170	Kapitali	1.000.000,00
17010	Kapitali themelues	1.000.000,00
200	Rezerva ligjore	200.000,00
20010	Rezerva ligjore	200.000,00
240	Fitimet (humbjet) e marra sërish	11.661.330,00
24010	Fitimet e viteve të mëparshëm fin.	11.767.202,00
24015	Fitimet e viteve të mëparshëm fin.	-105.872,00
DEBI		3.998.464,21
390	Debi kundrejt furnitorëve	18.463,21
39010	Debi kundrejt furnitorëve brenda vitit të ardhshëm fin.	18.463,21
3901010	Furnitorë të mirash dhe shërbimesh brenda vitit të ardhshëm	18.463,21
460	Debi të tjera	3.980.001,00
46015	Debi të tjera përveç vitit të ardhshëm fin.	3.980.001,00
4601510	Debi të ndryshme përveç vitit të ardhshëm fin.	3.980.001,00
460151015	Debi kundrejt ortakut kalim kuotash	3.980.001,00
	GJITHSEJ PASIVE	16.859.794,21
	FITIMI I VITIT FIN.	1.477.896,64
	TOTALI I RRUMBULLAKOSUR	18.337.690,83

DK SET – Kontabiliteti i përgjithshëm dhe të ardhurat
0037605 Sestante Holding Srl

20/02/2023

GJENDJA PASUORE NË SEKSIONE SIPAS KOMPETENCËS
Nga 01/01/2022 deri 31/12/2022

Parametra të tjerë: bilanci i mëparshëm, vetëm regjistrime me vlerë lokale

(pullë takse, vulë)

GJENDJA PASUORE



GJENDJA PASURORE NË SEKSIONE SIPAS KOMPETENCËS
Nga 01/01/2022 deri 31/12/2022

Parametra të tjerë: bilanci i mëparshëm, vetëm regjistrime me vlerë lokale

(pullë takse, vulë)

LLOGARIA EKONOMIKE

KOSTOT

KOSTOT E PRODHIMIT		108.639,22
690	Kostot e shërbimeve	54.062,25
69018	Kostot për shërbime e konsulencë	30.124,75
6901815	Konsukenca e shërbime komerciale	6.000,00
690181510	Shërbime komerciale	6.000,00
6901820	Konsulenca ligjore, fiskale e admin.	15.119,33
690182010	Konsulenca ligjore	4.110,00
690182015	Shërbime noteriale	1.560,56
690182025	Konsulenca fiskale e ekonomike	9.448,77
6901825	Shërbime admin e financiare	9.005,42
690182510	Shërbime përpunimi të dhënash kontabël	6.279,26
690182515	Shërbime përpunimi pagash	1,25
690182520	Shpenzime e shërbime bankare (jo financiare)	2.724,91
69024	Kosto për shërbime të përgjithshme e përdorime	23.937,50
6902430	Pagesa për shoqëri revizioni	23.937,50
690243010	Pagesa për revizion kontabël	23.937,50
760	Detyrime të ndryshme menaxhimi	54.576,97
76010	Tatime e taksa jo mbi të ardhurat	684,82
7601015	Pullë takse	168,36
760101510	Pullë takse	168,36
7601020	Taksa për koncesione të qeverisë	516,46
760102015	Taksa vjetore librat e shoqërisë	516,46
76020	Detyrime të tjera menaxhimi	53.892,15
76020015	Shpenzime për dhomën, kadastrën dhe të drejta të ndryshme	1.840,24
76020027	Sanksione tatimore e për sigurime shoq.	7,20
76020040	Bono e rumbullakosje pasive	0,02
76020107	Të ardhura të tjera të jashtëzakonshme pasive	52.044,69
DETYRIME FINANCIARE		4.592,22
850	Interesa e detyrime të tjera fin.	4.592,22
85010	Interesa e detyrime të tjera fin.	4.590,00

8501035	Minusv. tjetërsim i pjesëmarrjeve Pex	4.590,00
85015	Interesa e detyrime të tjera fin.	2,22
85015052	Interesa nga amendime operacionale	0,97
85015085	Shpenzime e shërbime bankare (fin.)	1,25
GJITHSEJ KOSTO		113,231,44
FITIMI I VITIT FIN.		1.477.896,64
GJITHSEJ ME RRUMBULLAKIM		1.591.128,08

FITIME/TË ARDHURA

VLERA E PRODHIMIT		2.333,76
640	Fitime të tjera e të ardhura	2.333,76
64012	Fitime të tjera, të ardhura që nuk hyjnë akt. admin.	2.333,76
6401233	Të ardhura aktive të zakonshme	2.333,76
TË ARDHURA FINANCIARE		1.588.794,32
800	Të ardhura nga pjesëmarrjet	1.588.762,98
80010	Të ardhura nga pjesëmarrjet, shoq. e grupit	1.588.762,98
8001014	Dividenti i shoq. kontr. sub. IRES	1.588.762,98
840	Të ardhura të tjera nga të mëparshmet	31,34
84015	Të ardhura të tjera fin. të ndryshme nga të mëparshmet	31,34
8401510	Interesa aktive bankare e postare	31,34
GJITHSEJ TË ARDHURA		1.591.128,08

ALPHA PAS NDARJES			
ASETE FINANCIARE	€ 5.111.200,00	PASURIA NETO	€ 13.342.227,00
Pjesëmarrje të pakontroll.	€ 5.111.300,00	Kapitali themeltar	€ 10.000,00
Alpine Invest	€ 500.000,00	Rezerva ligjore	€ 200.000,00
Local Web	€ 2.500.000,00	Fitimet/humbjet rishtaz	€ 11.651.300,00
IDS Italia	€ 1.000.000,00	Fitimet/humbjet e vitit fin.	€ 1.477.837,00
Homepal	€ 416.300,00		
Quiple	€ 10.000,00		
Botzen Inv.	€ 365.000,00		
November	€ 10.000,00		
Super Agenda	€ 10.000,00		
KREDI	€ 1.900.722,00	DEBITË	€ 3.998.464,00
Kredi të kontrolluara	€ 1.848.223,00	Debitë ndaj furnitorëve	€ 18.403,00
Alpine Invest	€ 1.383.000,00	Debitë ...	€ 3.980.001,00
Local Web	€ 20.220,00		
November	€ 410.000,00		
Best shop online	€ 25.000,00		
Kredi ...	€ 112.500,00		
DISPONIBILITETI LIKUID	€ 14.007,00		
GJITHSEJ AKTIVI	€ 7.098.000,00	GJITHSEJ PASIVI	€ 17.947.001,00
DEFICITI NGA NDARJA	€ 10.251.593,00		

BETA PAS NDARJES			
ASETE FINANCIARE	€ 10.001.593,00	PASURIA NETO	€ 10.000,00
Pjesëmarrje të pakontroll.	€ 10.001.593,00	Kapitali themeltar	€ 10.000,00
IDS	€ 10.000.000,00		
We Web	€ 732,00		
Direct24	€ 1,00		
BestShop Shpk	€ 800,00		
KREDI	€ 1.250.000,00	DEBITË	€ -
Kredi të kontrolluara	€ 1.250.000,00		
WeWeb	€ 1.250.000,00		
Local Web	€ 30.000,00		
PradiumTech			
DISPONIBILITETI LIKUID	€ -		
GJITHSEJ AKTIVI	€ 11.251.593,00	GJITHSEJ PASIVI	€ 10.000,00
		SUFICITI NGA NDARJA	€ 11.241.593,08

Kopje konform originalit në aktet e mia të cilën e lëshoj në letër të lirë për
përdorime të lejuara nga ligji.
Milano, 5 qershor 2023

(firma, vula e noterit)



APOSTIL

(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. Shteti: ITALIA
Ky akt publik
2. Është firmosur nga Mathias Bastrenta
3. Në cilësinë e NOTERIT
4. Mban siglën/VULËN NOTERIALE

Vërtetuar

- | | |
|--------------------------|-------------------|
| 5. në Milano | 6. më 09.06.2023 |
| 7. nga zyra e prokurorit | |
| 8. me nr. 6447 | 9. VULA E SHTETIT |
| 10. FIRMA | |

Për Zv. Prokurorin e Republikës
Dr. R. Guareschi
(firma, vula)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ELONA A. SYLA

DATE 05/07/2023
NR REP 3100



V2023052500152923865



VËRTETIM PËRKTHIMI

Vërtetohet firma e përkthyeses **Doriana Ndoi**, e njohur personalisht prej meje, i cili deklaroi në praninë time se përkthimi nga gjuha italiane në gjuhën shqipe është plotësisht në përputhje me dokumentin original bashkëngjitur dhe nënshkroi rregullisht përpara meje.

Noter
Elona A. Syla

